




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“High Speed” SH.P.K  
Nr. i biznesit 70641259  
Pronar – Sadat Ferati  
OK “High Speed”  
rr. Zahir Pajaziti nr. 152  
Podujevë



Ref: 1310/1470/LIC/II

### VENDIM

*për licencimin e Operatorit Kabllorë, “High Speed” SH.P.K - Podujevë*

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Kandidati për operatorë kabllorë “High Speed” SH.P.K, ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë më datën 26 shtator 2013.

#### Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati “High Speed” SH.P.K ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operatorë kabllorë, në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores për Distribuimin Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.
7. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operatorë kabllorë. Prandaj, Komisioni, vlerëson se një operatorë kabllorë mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve.
8. Kandidati për operatorë kabllorë “High Speed” SH.P.K, do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllorë.
9. Nëse, pas marrjes së licencës, kandidati për operatorë kabllorë “High Speed” SH.P.K siguron marrëveshje shtese apo të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllorë, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve të kandidatit. Kandidati “High Speed” SH.P.K obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t’i ketë siguruar ato.
10. Komisioni, vlerëson se “High Speed” SH.P.K ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënie e Licencës (KPM-2013/04).
11. Komisioni, vlerëson se, në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 kandidati për operatorë kabllorë “High Speed” SH.P.K ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### VENDIM


12. Në takimin e mbajtur më 30 tetor 2013, Komisioni merr vendim që, kandidatit të interesuar për licencë të operatorit kabllorë “High Speed” SH.P.K i cili planifikon të operojë në disa fshatra në Komunën e Podujevës, t’i lëshoj licencën e KPM-së për Operatorë Kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes rrjetit kabllorë.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor “High Speed” SH.P.K do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
14. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1 të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet medieve audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Operator Kabllor duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencë të Operatorëve Kabllorë, është i përcaktuar me Nenin 4.2.1. të rregullores së lartpërmendur në këtë paragraf.
15. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02 përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve programore “High Speed” SH.P.K duhet ta paguajë

taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.

16. Operatori kabllor “High Speed” SH.P.K, mund të fillojë me ofrimin e listës së programeve për klientët, vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

**Lëshimi i Vendimit**

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.

  
\_\_\_\_\_  
Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



30 tetor 2013  
datë